

Shtator 2022

# Sipërmarrjet Sociale si Partnerë Potencialë në Advokimin për Zhvillimin e Bashkëpunimit

Raporti për Shqipërinë



Ky publikim u bë i mundur përmes mbështetjes financiare të Komisionit Evropian (KE), Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), Irish Aid dhe IBON International nëpërmjet Partneritetit të OSHC-ve për Zhvillimin Efektiv (CPDE). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Komisionit Evropian (KE), Agjencisë Austriake të Zhvillimit (ADA), Irish Aid dhe IBON International.

©Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim  
Tiranë, Shqipëri 2022

*Klotilda Kosta*, Koordinator Hulumtimi  
Rishikimi i raportit

*Alis Mustafa*, Hulumtues Kryesor  
Mbledhja e të dhënave, analiza e të dhënave dhe hartimi i raportit

*Era Sherifaj*, Asistent Hulumtimi  
Mbledhja e të dhënave

*Maris Selamaj*  
Grafika dhe Faqosja



# Tabela e përmbajtjes

Lisa e Matricave .....	3
Lista e Figurave .....	3
Akronimet .....	4
<b>1. Hyrje .....</b>	<b>5</b>
1.1. Konteksi dhe objektivat .....	5
1.2. Metodologjia .....	6
1.3. Aktorët Kyç të Angazhuar në Studim .....	7
1.4. Pyetjet Kryesore Kërkimore për Aktorët .....	9
1.5. Pjesëmarrësit në Studim .....	10
1.6. Kufizimet e Studimit .....	15
1.7. Shtrirja Kohore dhe Rezultatet .....	16
<b>2. Gjetjet dhe Analiza .....</b>	<b>17</b>
2.1. Historiku dhe Konteksti i SS-ve në Shqipëri .....	17
2.2. Aktorët Kyç në Sektorin e SS-së .....	20
2.3. Sfidat dhe mundësitë për SS-të duke marrë në konsideratë kontekstin dhe kushtet në fushën/vendin e tyre të veprimit .....	25
2.4. Potencialet për Bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve dhe SS-ve në Advokimin për Zhvillimin e Bashkëpunimit .....	29
<b>3. Konkluzion dhe Rekomandime .....</b>	<b>30</b>
3.1. Konkluzion .....	30
3.2. Rekomandime .....	30
Referencat .....	31
Shtojcat .....	32
Shtojca 1 – Aktorët Kryesorë të Anagazhuar në Studim .....	32
Shtojca 2 – Matricat: Pyetjet Kryesore Kërkimore për të Intervistuarit Kyç nga Sektori i SS-ve .....	32

# Lista e Matricave

Matrica 1: Aktorët kryesorë të angazhuar në studim .....	32
Matrica 2: Pyetjet kryesore të kërkimit për institucionet burimore të SS-ve .....	34
Matrica 3: Pyetjet kryesore të kërkimit për rrjetin e SS-ve .....	36
Matrica 4: Pyetjet kryesore kërkimore për udhëheqësit / stafin kyç të SS-ve .....	37

# Lista e Figurave

Figura 1: Grupet kryesore të aktorëve të sektorit të SS-së .....	7
--	---

# Akronimet

ADA	-	Austrian Development Agency (Agjencia Autriake e Zhvillimit)
AIDA	-	Albanian Investment Development Agency (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve)
AICS	-	Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo (Agjencia Italiane per Bashkëpunimin e Zhvillimit)
BE	-	Bashkimi Evropian
CAUSE	-	Projekti “Confiscated Assets Used for Social Experimentations” (Përdorimi i pronave të konfiskuara për sipërmarrje sociale)
EC	-	European Commission
EMBRACE	-	Projekti “Entrepreneurship Models Building Relations and Creative Economy” (Modele Sipërmarrjeje që ndërtojnë Marrëdhënie dhe Ekonomi Krijuese)
MoU	-	Memorandum of Understanding (Memorandum Mirëkuptimi)
MSHMS	-	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NS	-	Ndërmarrje Sociale
OSHC	-	Organizatë e Shoqërisë Civile
PSh	-	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
RISE -ALB	-	Projekti “Strengthening of Social Entrepreneurship in Albania” (Fuqizimi i Sipërmarrjes Sociale në Shqipëri)
RISE	-	Inkubatori RISE - Regional Incubator for Social Enterprises (Inkubatori rajonal për sipërmarrjet sociale)
RYCO	-	Regional Youth Cooperation Office
SD	-	Sindroma Down
SS	-	Sipërmarrje Sociale
ShPK	-	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
TWIST	-	Projekti “Towards a new social entrepreneurship model in confiscated assets in Albania” (Drejt një Modeli të ri të Sipërmarrjes Sociale në asetet e konfiskuara në Shqipëri)
UMT	-	Universiteti Metropolitan Tirana
UNDP	-	United Nations Development Programme (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara)
UN Women	-	The United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women (Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave)
VKM	-	Vendim i Këshillit të Ministrave
WEE	-	Women’s Economic Empowerment (Fuqizimi Ekonomik i Grave)
YAPS	-	Youth Albania Professional Services
YSB Balkans	-	Yunus Social Business Balkans

# 1. Hyrje

## 1.1. Konteksti dhe Objektivat

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PSh) është një Organizatë Jo-fitimprurëse (OJF) shqiptare e pavarur, e themeluar në vitin 2001, që mbështet shoqërinë civile dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndër-sektorial me qëllim forcimin e institucioneve demokratike dhe avancimin e zhvillimit ekonomik. Fokusi i PSh bazohet në katër shtylla kryesore, përkatësisht: Mjedisi Mundësues dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm i Shoqërisë Civile; Sipërmarrja dhe Inovacioni Social; Aktiviteti Filantropik dhe Infrastruktura Mbështetëse; dhe Qeverisje me Pjesëmarrje Transparente dhe e Përgjegjshme. Në lidhje me shtyllën e Sipërmarrjes Sociale dhe Inovacionit, PSh jep kontributin e saj në kërkim dhe advokim, veçanërisht në lidhje me kuadrin ligjor të sipërmarrjeve sociale, si dhe ka qenë pioniere në studimet në lidhje me sipërmarrjen sociale në Shqipëri, duke mbuluar çështje të tilla si hartëzimi sektorial, sfidat dhe mundësitë në tregjet vendase, mbështetja ekzistuese financiare dhe institucionale, potenciali për zhvillim dhe roli i aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në zhvillimin e sipërmarrjes sociale. Partnerët Shqipëri ka qenë pjesë e disa nismave kërkimore mbi sipërmarrjet sociale dhe sipërmarrjen sociale në Ballkanin Perëndimor dhe në nivel evropian. Gjetjet kërkimore përbëjnë bazën e advokimit, mbështetur nga pjesëmarrja në rrjete të ndryshme si EMES, EUCLID, Rrjeti Ballkanik i Kërkimit për Sipërmarrjet Sociale, Diesis, etj.

Zhvillimi i sektorit të Ekonomisë Sociale dhe Sipërmarrjeve Sociale (SS) në Shqipëri është ende në fazat e tij fillestare, pavarësisht përpjekjeve të bëra nga aktorë të ndryshëm për të punuar në një terren të përbashkët dhe për të avancuar më tej në këtë drejtim. Në vitin 2016 hyri në fuqi ligji nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndjekur nga disa akte nënligjore të nxjerra në një periudhë tre-vjeçare. Paketa ligjore nuk është zbatuar efektivisht për shkak të rregulloreve të paqarta dhe të vështira, si dhe fondi publik i miratuar në mbështetje të ndërmarrjeve sociale nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk është shpërndarë, duke e shënuar këtë si një mundësi të humbur për zhvillimin e SS-ve në Shqipëri.

Objektivi kryesor i studimit në nivel vendor është të kontribuojë në formulimin e një agjende advokimi për zhvillimin e bashkëpunimit, duke promovuar sipërmarrjet sociale (SS) si aktorë kryesorë në zhvillimin e barabartë dhe të qëndrueshëm.

Objektivat specifike të hulumtimit janë:

- Identifikimi i aktorëve kryesorë në sektorin e SS-ve, të cilët janë të angazhuar ose mund të angazhohen potencialisht në advokimin për zhvillimin e bashkëpunimit;
- Përcaktimi i sfidave dhe mundësive për SS-të duke pasur parasysh kontekstin dhe kushtet që lidhen me zonën dhe në mënyrë specifike me vendin ku ato operojnë (Shqipëri); dhe
- Eksplorimi i strategjive dhe rekomandimeve për mënyrën se si Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) dhe aktorët kryesorë të sektorit të SS-së mund të bashkëpunojnë për të mbështetur dhe zhvilluar më tej sektorin e SS-së, si një element kyç në zhvillimin e barabartë dhe të qëndrueshëm.



## 1.2. Metodologjia

Metodologjia e ndjekur për zhvillimin e studimit në nivel vendor përbëhet nga dy faza kryesore: 'desk research' (hulumtim) dhe qasja cilësore.

Gjatë fazës 'Desk research' (hulumtimit), u realizua identifikimi i aktorëve kryesorë që kanë ndikim ose ndikohen nga sektori i sipërmarrjes sociale në Shqipëri, duke i kategorizuar në 9 kategori kryesore, bazuar në udhëzimet e dhëna për zhvillimin e studimit. Bazuar në këtë, u krijua një bazë të dhënash me aktorët kryesorë, duke përcaktuar edhe rolet specifike të secilit.

Në mënyrë që të gjenerohej një grup i përzgjedhur i informatorëve kryesorë, mbi këta aktorë u aplikuan kritere specifike të vlerësimit dhe përzgjedhjes. **Këto kritere përfshijnë:**

- Duke marrë në konsideratë shtrirjen dhe fokusin e studimit, SS-të që kanë një fokus të qartë në fuqizimin e grupeve përmes ofrimit të mundësive të punësimit, me fokus të veçantë në vetë-punësimin e grave apo veprimet e drejtuara drejt çështjeve me bazë gjinore; ose aktorët, puna e të cilëve është e fokusuar në promovimin e Fuqizimit Ekonomik të Grave (FEG: WEE – Women's Economic Empowerment);
- Aktorët që mbështesin drejtpërdrejt SS-të nëpërmjet programeve, veprimeve ose mekanizmave të tyre mbështetës.
- Aktorët që ofrojnë mbështetje financiare nëpërmjet granteve, ose mbështetje teknike nëpërmjet mentorimit, ngritjes së kapaciteteve dhe sesioneve trajnuese, për sipërmarrësit dhe bizneset 'Start-up', ku SS-të konsiderohen si përfitues, pavarësisht mungesës së fokusit apo kategorizimit specifik të këtyre mekanizmave për SS-të.

Gjatë fazës së Qasjes Cilësore, intervista u zgjodh si instrumenti më i përshtatshëm për mbledhjen e informacionit. Aktorët u grupuan në tre kategori, përkatësisht: Përfaqësues dhe Staf Kryesor të Udhëheqësve të SS-ve; Përfaqësues të Institucioneve Kryesore Burimore; Përfaqësues të Rrjeteve të SS-ve.

Për kategorinë e parë, përfaqësues të udhëheqësve kryesorë të SS-ve, 12 aktorë u identifikuan dhe u kontaktuan duke i ftuar për të qenë pjesë e intervistës. Nga këta, 5 prej tyre, kanë marrë statusin "Ndërmarrje Sociale" të dhënë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), ndërsa pjesa tjetër janë sipërmarrje sociale që operojnë në sektorin e SS-ve, të identifikuar nga nisma të tjera, kryesisht të zbatuara nga Partnerët Shqipëri. si EMBRACE, CAUSE, RISE-ALB, Konkursi i Bizneseve të Gjellërta, etj.

Nga kategoria e dytë, Institucionet Kryesore Burimore, u kontaktuan për t'u bërë pjesë e studimit: përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, nga Bashkia Tiranë; Ekspertë nga Akademia në Universitetin Metropolitan Tirana dhe Universitetin Polis; përfaqësues nga Institucionet Financiare (Tirana Bank dhe Credins Bank), përfaqësues nga institucionet e zhvillimit të kapaciteteve, si: BC Business Consultancy; dhe përfaqësues të agjencive shumëpalëshe të zhvillimit që mbështesin SS-të, si: UN Women dhe UNDP. Nga kjo kategori janë kontaktuar gjithsej 19 përfaqësues.

Nga kategoria e tretë, përfaqësues të Rrjeteve të SS-ve, Yunus Social Business Balkans u kontaktua për t'u bërë pjesë e studimit, si organizata zbatuese e aktiviteteve të Inkubatorit RISE në Shqipëri.

Intervistat u zhvilluan në ambientet e përfaqësuesve të institucioneve të përzgjedhura dhe nëpërmjet takimeve virtuale (online), duke përdorur platformën Zoom. Kohëzgjatja e tyre ishte rreth 45 minuta deri në 1 orë (me udhëheqësit e SS-ve). Materialet e regjistruara u transkriptuan dhe të dhënat u përpunuan për analiza të mëtejshme. Tre nga SS-të e intervistuar janë përzgjedhur si raste studimi dhe janë përfshirë në këtë raport.

## 1.3. Aktorët Kyç të Angazhuar në Studim




Figura 1: Grupet kryesore të aktorëve të sektorit të SS-së

Lloji dhe emri i aktorëve të përfshirë në studim, bazuar në kategorinë e tyre, është paraqitur si më poshtë:

### Udhëheqësit kryesorë të SS-ve:

- Klubi Kombëtar i Prindërve të Fëmijëve me Çrregullime të Spektrit Autik;
- Shoqata shqiptare për edukim, përkujdesje dhe trajnim, ACT-Center;
- Shoqata "Fuqizimi i Grave të Liqenit të Shkodrës" F.G.L.SH;
- Shoqata Kombëtare për Integrim, Zhvillim dhe Ndihmë për Shtresat në Nevojë (SHKIZH);
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV);
- Romix Community Comics
- Qedra Mami Care – Fondacioni Spitalor i Nënës dhe Fëmijës;
- Te Xhoni Café - Jonathan Center
- Drita Cleaning - Voice of Roma
- App Tour - Vjosa Explorer
- Made in Prison – Organizata Orkidea në Tiranë
- Qendra Rinore Arka - Code Partners Shkodër.



### Institucionet qeveritare (shtetërore) burimore të SS-ve

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Bashkia Tiranë: Drejtoria e Punësimit
- Bashkia Tiranë: Drejtoria e Investimeve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik
- Bashkia e Tiranës: Projekti për Fuqizimin e Grave, Projekti për Fuqizimin e të Rinjve
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

### Ekspertët nga fusha akademike:

- Universiteti Metropolitan Tirana
- Universiteti Polis

### Institucionet/organizatat financiare të SS-ve:

- Tirana Bank
- Credins Bank

### Aktorët që operojnë në fushën e kërkimit, zhvillimit të kapaciteteve ose ofruesit e teknologjisë për SS-të:

- BC Business Consultancy

### Agjencitë shumëpalëshe të zhvillimit që mbështesin SS-të:

- UN Women
- UNDP

### Rrjetet e SS-ve ose rrjetet/platformat shumëpalëshe që promovojnë sipërmarrjet sociale:

- Yunus Social Business Balkans

### SS-të rajonale ose globale ose institucionet burimore të SS-ve në vendet ku është zhvilluar studimi:

- Inkubatori RISE - Inkubatori Rajonal për Sipërmarrësit Socialë (Regional Incubator for Social Entrepreneurs), në nivel rajonal.

## 1.4. Pyetjet Kryesore Kërkimore për Aktorët

Për çdo aktor (grup interesi), intervista u zhvillua bazuar në disa pyetje specifike, sipas kategorisë në të cilën ishte pozicionuar secili aktor. Tre tipe pyetësorësh u hartuan, përkatësisht: Pyetësor për 'Përfaqësuesit dhe Stafi Kyç i Udhëheqësve Kryesorë të SS-ve', pyetësor për 'Përfaqësuesit e Institucioneve Kryesore Burimore' dhe pyetësor për 'Përfaqësuesit e Rrjetit të SS-ve'. Secili pyetësor është paraqitur në Aneksin 1.

Pyetjet u grupuan sipas qëllimit të tyre, si më poshtë: (i) pyetje që lidhen me fushën e veprimit të aktorëve; (ii) pyetje që lidhen me aktorët kryesorë të angazhuar në sektorin e SS-së ; (iii) pyetjet që adresojnë sfidat dhe mundësitë me të cilat përballen SS-të; dhe (iv) pyetje që lidhen me mundësitë për bashkëpunim ndërmjet aktorëve të ndryshëm të sektorit të SS-së dhe ofrimin e strategjive dhe rekomandimeve.

## 1.5. Pjesëmarrësit në Studim

Pavarësisht shtrirjes së ftesës te një sërë aktorësh që janë aktivë në sektorin e SS-së dhe në mbështetjen e ofruar për Sipërmarrjet Sociale dhe përfshirjes për të marrë pjesë në studim, pëlqimin për t'u bërë pjesë e tij e dhanë rreth 60% e përfaqësuesve të këtyre aktorëve.

Nga kategoria e parë "**Praktikantë/Liderë të rëndësishëm të SS-ve**", përqindja e pjesëmarrjes është 50%. Në studim morën pjesë gjashtë udhëheqës të SS-ve, nga 12 të ftuar. Pjesëmarrësit nga kjo kategori janë:

(i)

Dy SS që kanë marrë statusin "Ndërmarrje Sociale" nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përkatësisht:

- Klubi Kombëtar i Prindërve të Fëmijëve me Çrregullime të Spektrit Autik.
- Shoqata "Fuqizimi i Grave të Liqenit të Shkodrës" F.G.L.SH.

## UDHËHEQËSIT KRYESORË TË SS-VE"

### SS me status "Ndërmarrje Sociale":

- Klubi Kombëtar i Prindërve të Fëmijëve me ÇSA
- Shoqata "Fuqizimi i Grave të Liqenit të Shkodrës" F.G.L.SH



(ii)

Katër SS që janë mbështetur ose kanë përfituar grante nga mekanizma të ndryshëm mbështetës që veprojnë në Shqipëri, konkretisht:

- *Romix Community Toys* – SS që ka marrë mbështetje nga Bashkia e Tiranës, nga eventet “Start Up City” organizuar nga Universiteti Metropolitan Tirana, dhe nga “Green Business Competition” 2021, mekanizmi mbështetës i granteve i zbatuar nga Partnerët Shqipëri.
- *Mami Care Center* – Fondacioni Spitalor i Nënës dhe Fëmijës – SS që ka marrë mbështetje nëpërmjet projektit EMBRACE, zbatuar nga Partnerët Shqipëri.
- *Te Xhoni Café - Jonathan Center* - SS që ka marrë mbështetje nëpërmjet projektit EMBRACE, zbatuar nga Partnerët Shqipëri.
- *Drita Cleaning - Voice of Roma* – SS që ka marrë mbështetje përmes projektit EMBRACE, zbatuar nga Partnerët Shqipëri, dhe RISE-ALB: Fuqizimi i Sipërmarrjes Sociale në Shqipëri” zbatuar nga ENGIM Albania.

## UDHËHEQËSIT KRYESORË TË SS-VE

### SS fitues të çmimeve kombëtare / ndërkombëtare:

- Rommix Community Comics;
- Mami Care Center – Fondacioni Spitalor i Nënës dhe Fëmijës;
- Te Xhoni Café – Jonathan Center;
- Voice of Roma in Albania.

Nga kategoria “**Agjencitë qeveritare, OSHC-të dhe subjektet private**”, përqindja e pjesëmarrjes është 50%. Tre përfaqësues të institucioneve morën pjesë në studim, nga gjashtë të ftuar. Pjesëmarrësit nga kjo kategori janë:

(i)

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes – si institucioni përgjegjës për zhvillimin e sipërmarrjes.

(ii)

Drejtoria e Punësimit dhe Drejtoria e Investimeve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik pranë Bashkisë Tiranë.

## INSTITUCIONET BURIMORE TË SS-ve

### Institucionet burimore qeveritare / shtetërore:

- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Bashkia Tiranë.

Nga kategoria “**Organizata Mbështetëse**”, e cila përfshin organizatat që ndërmarrin mekanizma mbështetës ose që u mundësojnë SS-ve të përmbushin në mënyrë efektive misionin e tyre nëpërmjet ofrimit të mbështetjes financiare, kërkimore, ngritjes së kapaciteteve, advokimit, etj., përqindja e pjesëmarrjes është 50%. Në studim morën pjesë katër përfaqësues të organizatave, nga tetë të ftuar (të përfshirë). Pjesëmarrësit nga kjo kategori janë

(i)

Universiteti Metropolitan Tirana (UMT) – në bashkëpunim me qendrën e tij kërkimore ‘Metro Research Center’, dhe si pjesë e aktiviteteve kushtuar Inkubatorit Social ‘MetSIInc’, ka krijuar “Kurset e Sipërmarrjes Sociale”, të cilin po e zbaton për të dytin vit radhazi. Në të përfshihen mësimet virtuale (online), sesione trajnimi, video, aktivitete praktike, seminare dhe kampe për të gjithë të interesuarit. Në të njëjtën kohë, çdo vit organizohet event i “Start Up City”, ku në edicionin e këtij viti u nda dhe çmimi për “Sipërmarrësin më të mirë social” (Best Social Entrepreneur).

(ii)

Tirana Bank – institucion financiar bankë, i cili i ka kushtuar një rëndësi të veçantë Përgjegjësisë Sociale të Korporatës dhe këtë vit ka ofruar edhe mbështetje financiare për fituesit e “Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta” 2022 në Shqipëri.

(iii)

Banka Credins - institucion financiar bankë, i cili ndër vite është kthyer në një partner dhe sponsor të besueshëm të “Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta” në Shqipëri, duke mbështetur financiarisht sipërmarrjet sociale pjesëmarrëse në konkurs.

(iv)

BC Business Consultancy – një agjenci që operon në fushën e konsulencës së biznesit dhe marketingut digjital, duke ofruar ngritje kapacitetesh, mbështetje teknike dhe mentorim për sipërmarrjet dhe startup-et gjatë fazave të tyre të operimit. Agjencia ka ndërtuar mundësi bashkëpunimi me UMT-në dhe institucione të tjera, në mbështetje të SS-ve.

## INSTITUCIONET BURIMORE TË SS-ve

### Organizatrat mbështetëse:

- Universiteti Metropolitan Tirana;
- Tirana Bank;
- Banka Credins;
- BC Business Consultancy



Nga kategoria “**Rrjetet ose platformat shumëpalëshe të SS-ve** ” shkalla e pjesëmarrjes është 100%, çka nënkupton që të dy institucionet e ftuara për të marrë pjesë në studim, janë bërë pjesë e tij. Pjesëmarrësit nga kjo kategori janë:

(i)

Yunus Social Business - YSB Balkans synon të pajisë sipërmarrësit socialë dhe të rinj me njohuritë, aftësitë dhe mjetet e nevojshme për të projektuar, testuar, ngritur dhe zhvilluar iniciativat sipërmarrëse që kanë potencial për të krijuar ndikim pozitiv social për shoqërinë në vendet e Ballkanit Perëndimor.

(ii)

Inkubatori Rajonal për Sipërmarrësit Socialë RISE – është një program rajonal i mbështetur nga RYCO në Shqipëri, i cili ka krijuar struktura lokale në vendet e Ballkanit Perëndimor, për të promovuar dhe mbështetur sipërmarrjen sociale të të rinjve. RISE ka krijuar një rrjet rajonal të sipërmarrësve të rinj socialë, të quajtur "Risers", duke i mbështetur ata në kthimin në realitet të ideve të tyre.

## INSTITUCIONET BURIMORE TË SS-ve

### Rrjetet e SS-ve, platformat shumëpalëshe:


-  Yunus Social Business
-  Inkubatori Rajonal për Sipërmarrësit Socialë RISE

## 1.6. Kufizimet e Studimit


Një prej kufizimeve të studimit, mund t'i atribuohet hezitimit të aktorëve të përfshirë, për të qenë pjesë e procesit të mbledhjes së të dhënave. Pavarësisht shtrirjes së ftesës për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në studim të 30 aktorë, përgjegjësia funksionale e të cilëve lidhet me sektorin e SS-ve, të cilët kanë një rol aktiv në këtë sektor ose ndikohen nga SS-të, vetëm 15 prej tyre iu përgjigjën pozitivisht ftesës dhe morën pjesë në studim.

Në kuadër të këtij hulumtimi, është ngritur supozimi se pyetjet që kanë të bëjnë me grupet të cilave SS-të u ofrojnë produktet apo shërbimet e tyre duke përfshirë këtu të varfrit, gjejnë zbatim edhe për grupet e tjera të pafavorizuara apo vulnerabël, siç janë: gratë, grupet e marginalizuara, kategoritë në nevojë, personat me aftësi të kufizuara dhe komuniteti Rom dhe Egjiptian.

## 1.7. Shtrirja Kohore dhe Rezultatet



Për realizimin e studimit u identifikuan katër faza kryesore, duke kontribuar kështu në përmbushjen e objektivit të përgjithshëm të tij, i cili ka të bëjë me hartimin e një agjende bashkëpunimi dhe advokimi, që promovon SS-të si aktorë kryesorë në zhvillimin e barabartë dhe të qëndrueshëm:





# 2. Gjetjet dhe Analiza

## 2.1. Historiku dhe Konteksti i SS-ve në Shqipëri

Sektori i Sipërmarrjes Sociale në Shqipëri është ende në fazën fillestare, ndërkohë që ka ende shumë paqartësi në lidhje me funksionimin e sipërmarrjeve sociale. Forma e parë e Sipërmarrjes Sociale në Shqipëri mund të konsiderohet tipi Kooperativë. Kooperativat u krijuan gjatë periudhës komuniste, ku toka u shpronësua nga grupet e fermerëve, të cilët u detyruan të punonin në kooperativë për të vazhduar prodhimin e tyre bujqësor dhe blegtorial. Në këtë formë organizimi, fermerët nuk kishin zgjedhje mbi prodhimin dhe anëtarët e kooperativës nuk kishin të drejta pronësie mbi kapitalin, pajisjet e prodhimit, makineritë apo produktet e tyre. Të gjitha tokat dhe pronat që kishin qenë në pronësi private para regjimit komunist, tashmë zotëroheshin nga shteti. Punëtorët 'zotëronin' vetëm punën e tyre fizike, e cila paguhej pak (Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2019). Perceptimi negativ në lidhje me kooperativat është ende i pranishëm në Shqipëri, pavarësisht ndryshimit të formës së tyre të funksionimit që nga ajo kohë, si dhe tranzicionit politik drejt demokracisë në vitin 1992. Për më tepër, publiku i gjerë e lidh veprimtarinë e kooperativave tërësisht me prodhimin bujqësor.

Por që nga ajo kohë, në Shqipëri janë shfaqur lloje të ndryshme sipërmarrjesh sociale. Nismat e para u krijuan nga sektori jofitimprurës, të nxitura dhe të mbështetura nga investimet e huaja (Partnerët Shqipëri 2013). Pavarësisht se shumica e sipërmarrjeve sociale e kanë filluar aktivitetin e tyre duke u regjistruar si organizata jofitimprurëse, ekosistemi përfshin edhe forma të tjera ligjore, siç janë subjektet fitimprurëse. Shumica e sipërmarrjeve sociale të krijuara së fundmi kanë zgjedhur formën ligjore fitimprurëse për të regjistruar subjektin e tyre, duke pasur parasysh se kjo formë konsiderohet si forma më e përshtatshme për të operuar si sipërmarrje sociale, për shkak të fleksibilitetit për sa i përket llojit të aktiviteteve ekonomike që mbulon dhe pasjes së më pak barrierave operacionale, në krahasim me format e tjera ligjore. OJF-të, të cilat ende përbëjnë shumicën dërrmuese të sipërmarrjeve sociale shqiptare, fokusohen në ofrimin dhe përfshirjen e shërbimeve sociale që luftojnë përjashtimin social dhe kompensojnë hendeqet e krijuara nga agjencitë publike të ofrimit të shërbimeve. Sipërmarrjet sociale ofrojnë shërbime për grupet e pafavorizuara, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara fizike, personat me çrregullime të shëndetit mendor, fëmijët me nevoja të veçanta, gratë dhe vajzat që janë viktima të trafikimit, etj.

Në vitin 2016 u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë ligji Nr. 65 "Për Ndërmarrjet Sociale", i cili do të mundësonte mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri. Shumë aspekte janë ende të pambuluara nga ligji, si dhe ka pasur një diskutim publik në lidhje me shtrirjen dhe mbulimin e këtij ligji, duke qenë se sipas tij, vetëm organizatat jofitimprurëse (OJF) njihen si formë ligjore që kanë të drejtë të përfitojnë nga statusi i Ndërmarrjes Sociale, duke përjashtuar të gjitha format e tjera të organizimit, siç janë Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK) dhe Kooperativat Bujqësore. Ligji u pasua me miratimin e VKM-së "Për Krijimin e Fondit të Mbështetjes së Ndërmarrjeve Sociale dhe Formularët e Mbështetjes nga Filialet për Ndërmarrjet Sociale", sipas së cilës për periudhën 2019-2021 u caktua një fond prej 249,760,000 lekësh, por që nuk iu shpërnda asnjë prej NS-ve.

Një prej organizatave të para që përmbushin përkufizimin operacional të BE-së për Sipërmarrjen Sociale është organizata Youth Albania Professional Services (YAPS)[1]. YAPS është themeluar në vitin 2000 nga një grup donatorësh dhe biznesesh, të cilët janë edhe anëtarë të bordit të SE-së. YAPS përmbush misionin e tij duke integruar grupet e marginalizuara në tregun e punës, duke qenë se punëson njerëz që i përkasin komunitetit Rom, jetimë, gra dhe të rinj të papunë, ish të burgosur dhe persona me aftësi të kufizuara fizike. Fondacioni ofron shpërndarjen e postës dhe shërbime pastrimi kryesisht për anëtarët e bordit të tij dhe për korporatat e tjera, spitalet dhe ambasadat. YAPS e filloi aktivitetin me ofrimin e 600 shërbimeve në muaj dhe sot numri i shërbimeve është afërsisht 100,000 në muaj. Ajo operon në Tiranë dhe zonat e saj periferike (Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2019).

---

[1] Faqja zyrtare web e YAPS: [www.yaps.al](http://www.yaps.al)



## "Te Xhoni" Café

"Te Xhoni" Café është një sipërmarrje sociale e themeluar nga qendra Jonathan, një OJQ e themeluar në vitin 2011 duke pasur si mision mbështetjen e fëmijëve me Sindromën Down për të patur një jetë të pavarur dhe për t'i integruar ata në shoqërinë shqiptare me të drejta të plota, nëpërmjet terapive të specializuara[2]

Te Xhoni Café u hap në ditën globale të Sindromës Down, më 21 Mars 2017. Ai shërben si vendi ku të rinjtë me Sindromën Down mund të ndjekin kurse për përfitimin e aftësive dhe si një mjedis ku prindërit e fëmijëve mund të kalojnë kohë me njëri-tjetrin ndërsa fëmijët e tyre marrin pjesë në seancat e terapisë. Ai shërben gjithashtu si një vend që kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit mbi potencialin e të rinjve me Sindromën Down për të qenë të pavarur dhe për t'u punësuar, si dhe për të gjeneruar të ardhura të cilat do të shkojnë në mbështetje të aktivitetit kryesor të organizatës në mbështetje të komunitetit me Sindromën Down në Shqipëri. Kapitali fillestar i investuar në kafenenë "Te Xhoni" ishte 10,000 Euro dhe ajo u mbështet më tej nga granti i ofruar nëpërmjet projektit EMBRACE[3] zbatuar nga Partnerët Shqipëri, në vlerën 21,134 Euro[4].

### **Përshkrimi i SS-së**

SS-ja është ngritur në ambientet e organizatës. Ajo është konceptuar si një vend ku njerëzit organizojnë lloje të ndryshme aktiviteteve. Te Xhoni pozicionohet në një zonë të aksesueshme, me një strukturë komode të jashtme dhe të brendshme. Objektivi kryesor i SS-së janë prindërit e komunitetit me Sindromën Down në Shqipëri, të cilët përfitojnë nga trajnimet e ofruara në qendër. Ajo shërben si një vend rrjetëzimi dhe ndërveprimi për të gjithë prindërit gjatë kohës që ata sjellin fëmijët e tyre në qendër, duke u konsideruar edhe si një vend i mirë për zhvillimin e mbështetjes në grup. Shërbimet e ofruara promovohen intensivisht, duke rezultuar në krijimin dhe mbajtjen e dy klientëve të përhershëm dhe gjithashtu në rezervime në raste aktiviteteve të veçanta, si festa ditëlindjesh dhe aktivitete karaoke. Te Xhoni Café ofron mundësi punësimi për personat me Sindromën Down. Aktualisht, SS-ja ka tre punonjës, të cilët punojnë me kohë të pjesshme dhe kohë të plotë, njëra prej të cilëve është një grua e re me Sindromën Down.

### **Angazhimi dhe Mbështetja e SS-së ndaj Sektorëve të Varfërisë**

Grupi kryesor i synuar i SS-së janë familjet e komunitetit me Sindromën Down në Shqipëri, mbështetës të tjerë të kauzës, organizata të ndryshme, kryesisht OJF që përdorin shërbimet për zbatimin e aktiviteteve të tyre, si dhe komuniteti më i gjerë. SS-ja ka arritur të ofrojë mundësi punësimi për 14 të rinj me Sindromën Down vetëm vitin e fundit, të angazhuar në sektorin e shërbimit të kafenesë. Synimi ishte që këta të rinj të kryenin aktivitete që lidhen me kafenenë, pavarësisht se ndonjëherë mungojnë vendet e lira (pozicionet vakante) për këto lloj shërbimesh. Deri më tani, 6 të rinj janë të angazhuar në sektorin e kuzhinës dhe kafenesë.

### **Përparësitë dhe Kufizimet e Angazhimit dhe Mbështetjes së SS-së ndaj Sektorëve të Varfërisë**

Fuqia kryesore e SS-së është fokusi në fuqizimin, jo vetëm të të rinjtve me Sindromën Down, por edhe i prindërve të tyre dhe komunitetin që i mbështet ata. Prindërit nxiten që të advokojnë për fëmijët e tyre në kontekstin ku ata bëjnë pjesë. Ndonjëherë lind një sfidë e re çdo ditë për çdo prind dhe ata duhet të kuptojnë se sfidat kryesore nuk zgjidhen gjithmonë nëpërmjet organizatës.

### **Fitimet dhe përfitimet e nxjerra nga sektorët e varfërisë**

Pavarësisht shërbimeve të drejtpërdrejta që u ofrohen fëmijëve me Sindromën Down, të tilla si terapi individuale apo në grup, mundësi për përfshirje dhe fuqizim përmes mundësive të punësimit, përfitues janë edhe prindërit e fëmijëve. Një përpjekje e konsiderueshme bëhet për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për çështjet me të cilat përballen çdo ditë fëmijët me Sindromën Down, si dhe ata gjithashtu përfitojnë nga iniciativat advokuese të ndërmarra nga organizata me angazhimin e tyre për të rritur përfshirjen e fëmijëve të tyre në aktiviteteve të përditshme në shkollë dhe mjedise të tjera.

[2] <https://resourcecentre.al/directory-dir-cso/listing/jonathan-center/>

[3] Broshura informuese e Sipërmarrjes Sociale "Te Xhoni Café", mbështetur nëpërmjet projektit EMBRACE: <file:///C:/ALIS/WORK/Partners%20Albania/CPDE/Empowering%20Jonathan%20Center%20with%20financial%20sustainability%20through%20its%20social%20business%20TE%20XHONI%20CAFE.pdf>

[4] Sipërmarrjet e mbështetura nëpërmjet projektit EMBRACE: <https://partnersalbania.org/embrace-entrepreneurship-models-building-relations-and-creative-economy/>

### **Mekanizmat e nevojshëm për të ofruar mbështetje për sektorët e varfërisë**

Institucionet, veçanërisht ato publike dhe qeveritare, duhet të përmbushin përgjegjësinë e tyre funksionale. Organizatat që kanë një objektiv specifik në këtë çështje, duhet të bëhen më aktive dhe “agresive” në “betejën” e bërjes së institucioneve publike më mbështetëse ndaj kësaj kategorie sociale (fëmijë/të rinj me Sindromën Down në Shqipëri). Përveç detyrimit ligjor për punësimin e një personi me nevoja të veçanta për çdo 25 punonjës në një organizatë, ky detyrim duhet të zbatohet në çdo institucion publik.

Një fokus i veçantë duhet t'i kushtohet edhe ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të familjeve dhe prindërve, për t'u kthyer në avokatë të nevojave të veçanta dhe si një mënyrë që komuniteti të jetë më reagues ndaj këtij grupi.

### **Angazhimi aktual me organizatat qeveritare, OSHC-të dhe organizatat e tjera**

Forma kryesore e angazhimit me aktorë të tjerë, veçanërisht organizata dhe institucione publike apo private, deri më tani ka qenë nëpërmjet promovimit dhe informimit për shërbimet që Te Xhoni Café ofron si dhe mundësinë për të eksploruar dhe shfrytëzuar këto shërbime për organizimin e aktiviteteve të ndryshme në ambientet e SS-së. Po ashtu, është vendosur fokusi edhe në angazhimin e Bashkisë.

Një formë tjetër angazhimi ka qenë nëpërmjet partneritetit dhe bashkëpunimit me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, për të ndërmarrë veprime specifike të nevojshme për punësimin e të rinjve me Sindromën Down në Shqipëri. Ky është një partneritet i vazhdueshëm që ka rezultuar i suksesshëm përgjatë viteve.

Po ashtu, është vendosur një bashkëpunim dhe nënshkruar një memorandum me dy universitete, qëllimi i të cilit është që studentët në vitin e fundit të diplomimit që vijnë nga këto universitete, të kenë mundësinë të kryejnë praktikën e punës në ambientet e organizatës dhe të sipërmarrjes sociale.



## 2.2. Aktorët Kyç në Sektorin e SS-së

Zhvillimi me hapa të ngadaltë i sektorit të SS-së dhe faza aktuale e SS-së ka kontribuar në krijimin e një ekosistemi me një numër të ulët të grupeve të interesit dhe të aktorëve kryesorë të përfshirë, të cilët kanë ndikim në zhvillimin e vetë sektorit. Një nga sfidat kryesore në lidhje me sektorin e SS-së, e identifikuar nëpërmjet këtij studimi është mungesa e ndërgjegjësimit të aktorëve kryesorë, që janë pjesë e ekosistemit. Të intervistuarit ishin në dijeni të bashkëpunëtorëve të tyre më të afërt, por ata nuk kishin informacion në lidhje me ekosistemin në tërësi. Veçanërisht për sa i përket identifikimit të Sipërmarrjeve Sociale që janë të suksesshme në gjenerimin e të ardhurave, apo që operojnë me sukses drejt përmbushjes së misionit dhe objektivave të tyre, përfaqësuesit e aktorëve kryesorë të angazhuar në studim, hezituan të përgjigjen për shkak të mungesës së informacionit. Disa nga SS-të e përmendura gjatë intervistave me aktorët janë: “Ejona Café”, “New York Bagels”, “Romix Community Comics”, “Ndihamoni Jetën”, “Frut Alpine”, “Shtëpia e Zotërinjve”, “KeBuono”, “Shërbime Pastrimi Drita”, etj.

### Shërbime Pastrimi "Drita"

Shërbime Pastrimi Drita filloi si një nismë e administratorit të saj. Pasi fitoi përvojë pune në organizata të shoqërisë civile dhe në një kompani ofruese shërbimesh në Greqi, ai vendosi të zbatojë të njëjtën praktikë edhe në Shqipëri, duke punuar me organizata të shoqërisë civile që mbështesin komunitetin Rom dhe Egjiptian dhe duke ofruar njëkohësisht shërbimet e pastrimit. SS-ja filloi aktivitetin me grantin e dhënë nëpërmjet projektit EMBRACE, i cili u përdor për blerjen e makinerive dhe pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit ekonomik të SS-së. Kapitali fillestar i investuar ishte 3,500 euro nga fondet personale, si dhe granti i dhënë në shumën prej 6,323 euro[5]. Kapitali i investuar tashmë ka arritur vlerën 20,000 – 22,000 euro, një pjesë e të cilave vjen nga aktiviteti ekonomik i SS-së.

#### Përshkrimi i SS-së

Shërbime Pastrimi Drita filloi të funksionojë si nën-aktivitet i shoqatës “Voice of Roma in Albania”, një OJQ aktive në sektorin e shërbimeve, fokusi kryesor i së cilës është nxitja e zhvillimit social dhe ekonomik të komunitetit Rom dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare, nëpërmjet fuqizimit të të rinjve, rritjes së punësimit, aksesit në arsim, shërbime shëndetësore, strehim, etj. Shërbime Pastrimi Drita është një SS që operon në sektorin e shërbimeve të pastrimit, duke ofruar shërbime të pastrimit të përgjithshëm dhe pastrimit të tapeteve për komunitetin. Klientët janë kryesisht institucionet publike dhe private, por edhe komuniteti më i gjerë. SS-ja e ka filluar aktivitetin dhe i ka ambientet e saj në qytetin e Fierit, por ofron shërbimet në të gjithë vendin. Shërbimet ofrohen nga punonjës të punësuar me kohë të plotë, por ka raste kur kontraktohen punonjësit me kohë të pjesshme në raste të kërkesës së lartë në treg. Kanalet kryesore për promovimin e SS-së janë mediat sociale, si Instagram dhe Facebook.

#### Angazhimi dhe Mbështetja e SS-së për Sektorët e Varfërisë

Mbështetja kryesore që i ofrohet komunitetit janë shërbimet e punësimit, me fokus pjesëtarët e komunitetit Rom. Deri më tani, SE ka të punësuar tre të rinj, dy burra dhe një grua, dy prej tyre nga komuniteti rom dhe një me dëmtim të dëgjimit dhe shikimit. Ata u arritën në bashkëpunim me Zyrën e Punës pasi që të tre vinin nga persona të papunë të regjistruar në këtë zyrë. Në rast të kërkesës më të madhe nga klientët, nënkontraktohen punonjës me kohë të pjesshme, të cilët i nënshtrohen programeve të trajnimit përpara zbatimit të shërbimeve, si:

[5] <https://partnersalbania.org/embrace-entrepreneurship-models-building-relations-and-creative-economy/>

shërbimi ndaj klientit, etika dhe sjellja e punës, kënaqësia e klientit, etj. Ka potencial për punësimin për më shumë se 10 punonjës të nënkontraktuar, bazuar në kërkesën e klientit dhe sezoni.

Pavarësisht se fokusi është te njerëzit që vijnë nga komuniteti rom, Shërbime Pastrimi Drita synon të krijojë sinergji dhe të punësojë njerëz nga të gjitha komunitetet. Pjesa më e madhe e punonjësve janë gra, veçanërisht gjatë sezonit të verës që konsiderohet edhe si “sezoni i pastrimit”, për shkak të përfshirjes së hoteleve dhe njësive akomoduese në këtë ofertë.

### **Përparësitë dhe Kufizimet e Angazhimit dhe Mbështetjes së NS ndaj Sektorëve të Varfërisë**

Një nga pikat kryesore të forta të NS-së është konsideruar gjithmonë angazhimi dhe përfshirja e komunitetit rom. Kjo ka ndikuar pozitivisht në familje, veçanërisht në ato në nevojë. Fillimisht, fokusi i organizatës ka qenë në projektet që kanë të bëjnë me edukimin e fëmijëve nga komuniteti rom. Duke qenë se mungesa e punësimit konsiderohet si një nga çështjet kryesore, angazhimi i prindërve dhe ofrimi i mundësive për punësim, ka kontribuar në rritjen e mirëqenies së familjes, pra edhe të mirëqenies së fëmijëve.

### **Fitimet dhe përfitimet e nxjerra nga sektorët e varfërisë**

Përfitimi kryesor për komunitetin rom është sigurimi i stabilitetit dhe ulja e nevojës për të qenë në lëvizje të vazhdueshme. Ky komunitet është i njohur si një komunitet “lëvizës” (nomad), gjithmonë duke u përpjekur të kërkojë azil në vende të tjera. Krijimi i punësimit për anëtarët e komunitetit, ka kontribuar në rritjen e stabilitetit të tyre dhe mungesës së vullnetit për të kërkuar azil jashtë vendit.

Një përfitim tjetër ka qenë rritja e kapaciteteve dhe aftësive të personave të angazhuar përmes ofrimit të trajnimeve dhe seancave të ngritjes së kapaciteteve, para zbatimit të shërbimeve të pastrimit. Aftësitë e fituara mund të zbatohen gjithmonë në mjedise të ndryshme

### **Mekanizmat e nevojshëm për të mbështetur sektorët e varfërisë**

Sfida kryesore me të cilën përballlet SS-ja është mungesa e fitimit dhe ekzistenca e mundësive të qëndrueshme financiare. Shuma e vogël e të ardhurave gjeneruar nga aktiviteti i biznesit ripërdoret për funksionimin e SS-së. Si burime të vetme të mbështetjes financiare të përfituara deri më tani kanë shërbyer grantet e përfituara nëpërmjet projektit EMBRACE dhe projektit RISE-ALB, të përdorura kryesisht për blerjen e pajisjeve dhe makinerive.

Me planet e reja për zgjerimin e aktivitetit të biznesit në ofrimin e shërbimeve të pastrimit të rrobave (tekstile) dhe batanijeve, si dhe mungesën e makinerive dhe pajisjeve për të mundësuar ofrimin e këtyre shërbimeve, ekziston gjithmonë nevoja për mekanizma mbështetës financiarë të qëndrueshëm dhe që vijnë nga institucionet qeveritare. Po ashtu, bashkëpunimi me Zyrën e Punës dhe agjencitë e tjera të punësimit janë thelbësore për ofrimin e mundësive të punësimit dhe krijimin e rrjeteve ndërmjet këtyre agjencive dhe SS-ve.

### **Angazhimi aktual me organizatat qeveritare, OSHC-të dhe organizatat e tjera**

Deri më tani, janë krijuar bashkëpunime me OSHC-të, si Partnerët Shqipëri dhe ENGIM, nëpërmjet grantit të dhënë dhe ofrimit të mbështetjes, si dhe me zyrat e punës për krijimin e lidhjeve ndërmjet tregut të punës dhe SS-ve.

Deri më tani ka pasur shumë përpjekje për të vendosur ura komunikimi me pushtetin vendor, të cilat kanë rezultuar në mungesën e reagimeve nga ana e tyre. Mungon bashkëpunimi me pushtetin vendor pavarësisht përpjekjeve të bëra në këtë drejtim..

Në studim janë përfshirë edhe aktorë të tjerë kyç që operojnë në fushën e sipërmarrjes sociale në Shqipëri, duke u bazuar në punën dhe studimet e ndërmarra nga Partnerët Shqipëri në këtë drejtim. Disa prej tyre, siç shpjegohet edhe në vijim, nuk operojnë në mënyrë specifike në fushën e SS-së por më tepër synojnë sipërmarrjen tradicionale si një fushë më e gjerë dhe zhvillimin e saj nëpërmjet ofrimit të mekanizmave mbështetës. Këto grupe interesi kategorizohen në bazë të fushës së tyre të veprimit dhe përgjegjësisë funksionale në: Institucione akademike dhe kërkimore; Organizatat mbështetëse; Institucionet qeveritare; dhe Institucionet financiare.



Pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës, zhvillohet një lëndë mësimore e titulluar “Biznesi Social”, nëpërmjet të cilës, studentet e nivelit “Bachelor” të degës Administrim dhe Politika Sociale, pajisjen me parimet dhe njohuritë bazë në lidhje me funksionimin e një biznesi social.

Universiteti Epoka ka ngritur një program mbi biznesin social dhe sistemet e qëndrueshme (ECOSSS) duke u bazuar në modelin Yunus, si dhe ka zhvilluar disa konferenca shkencore në këtë drejtim. Programi nuk është më aktiv aktualisht, por konsistonte në mësimin, kërkimin e aplikuar dhe zhvillimin e bizneseve sociale.

Për të dytin vit radhazi, Universiteti Metropolitan dhe Metro Research, si pjesë e aktiviteteve në kuadër të Inkubatorit Social MetSInc[6], kanë hartuar “Kurset e Sipërmarrjes Sociale II”, kurse këto të ndërtuara mbi zhvillimin e mësimëve online, seancave të trajnimit, videove, aktiviteteve praktike, seminareve dhe kampeve për të gjithë të interesuarit në këtë drejtim.

### MetSInc

Inkubatori Social i Metropolitan (MetSInc) është Inkubatori i parë Social në Shqipëri dhe Evropën Qendrore dhe Lindore, i përfshirë në Universitetin Metropolitan të Tiranës dhe financuar nga AUF. MetSInc synon të identifikojë dhe inkurajojë sipërmarrësit më të talentuar dhe t'i ndihmojë ata në ngritjen e sipërmarrjeve sociale të suksesshme dhe krijimin e mjediseve inovatore dhe produktive.

Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës dhe Tirana Business University, kanë në programin e tyre mësimor lëndë që trajtojnë dhe lidhen me sipërmarrjen dhe inovacionin, por nuk kanë një program studimi të përshtatur për sipërmarrjen sociale. Të dy institucionet organizojnë konkurse për të identifikuar startup-e dhe ide premtuese biznesi, disa prej të cilave kontribuojnë në arritjen e ndikimit social në komunitet ose grupet e synuara prej tyre.

Partnerët Shqipëri ka qenë pionier i kërkimit mbi ekonominë sociale dhe sipërmarrjen sociale, si pjesë e fushës programatike të Sipërmarrjes dhe Inovacionit Social.

Inkubatori Rajonal për Sipërmarrësit Socialë (RISE)[7] është një program rajonal i mbështetur nga RYCO, i cili ka ngritur struktura lokale në vendet e Ballkanit Perëndimor, për të nxitur sipërmarrjen sociale të rinjtë. Ai ka publikuar edhe një studim rajonal mbi zhvillimin e Sipërmarrjes Sociale në secilin vend specifik.

### Inkubatori RISE

U prezantua në 1 tetor të vitit 2019. RISE synon të mbështesë sektorin e sipërmarrjes sociale në Ballkanin Perëndimor. RISE mbështet të rinjtë guximtarë për të zhvilluar idetë e tyre në biznese sociale të qëndrueshme. Zbatimi në nivel lokal i RISE mundësohet nga inkubatorët lokalë socialë në rajon: ARNO (Maqedonia e Veriut), Nesto Vise, (Bosnjë-Hercegovinë), Yunus Social Business Balkans (Shqipëri), Smart Kolektiv (Serbi), IEC Technopolis (Mali i Zi) dhe Balkan Green Foundation (Kosovë).

[6] Faqja zyrtare web e Inkubatorit Social të UMT: <https://umt.edu.al/metsinc->

[7] Faqja zyrtare web e Inkubatorit Rajonal për Sipërmarrësit Socialë (RISE): <https://www.risewb.org/>

## Organizatat mbështetëse:

Këto organizata ofrojnë infrastrukturën e inkubatorit dhe përshejtuesit, ose programeve të ngjashme, dhe disa prej tyre funksionojnë si qendra inovacioni:

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, nëpërmjet zbatimit të projekteve “EMBRACE – Modele Sipërmarrjeje, që Ndërtojnë Marrëdhënie dhe Ekonomi Krijuese”, “C.A.U.S.E” - Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale”, “Konkursi i Bizneseve të Gjelbërta”, “TWIST – Drejt një Modeli të Ri të Sipërmarrjes Sociale në Asetet e Konfiskuara në Shqipëri” dhe platformës Dua Partner Invest[8] kushtuar ekosistemit të sipërmarrjes dhe inovacionit social, duke bashkuar tre kategoritë kryesore: sipërmarrësit, konsulentët dhe investitorët.

### Dua Partner Invest

Është nisma më e fundit e Partnerëve Shqipëri në fushën e Sipërmarrjes dhe Inovacionit Social. Platforma përfshin një mundësi unike që u mundëson investitorëve në mbarë botën të investojnë në startup-et rajonale që gjenerojnë një ndikim social ose mjedisor, dhe u mundëson startup-eve inovative në rajonin e Ballkanit Perëndimor që të kontaktojnë me një komunitet të gjerë ekspertësh dhe të kenë akses në mundësi financimi.

Yunus Social Business Balkans[9], vepron si një OJQ që mbështet sipërmarrësit dhe zhvillimin e sektorit gjithëpërfshirës të sipërmarrjes sociale në rajon.

Growpreneur[10], vepron si një program Inkubimi dhe Përshejtimi, duke nxitur sipërmarrësit që të projektojnë, testojnë dhe ndërtojnë zgjidhje të qëndrueshme të cilat u japin përgjigje nevojave reale të klientëve dhe gjenerojnë ndikim pozitiv për shoqërinë.

IDEA, ofron mbështetje për idetë inovatore të biznesit, iniciativat sipërmarrëse, punësimin, etj.

Grand Thorton Albania, një kompani që ofron pro-bono ligjore dhe biznesi, për sipërmarrjet e reja të gjelbra, duke bashkëpunuar me Partnerët Shqipëri për konkursin kombëtar të bizneseve të gjelbërta.

One Telecommunications, kompani që operon në sektorin e teknologjisë dhe komunikimit, që ka mbështetur financiarisht ndër vite start-up-et e gjelbra, nëpërmjet bashkëpunimit me Partnerët Shqipëri në konkursin kombëtar të bizneseve të gjelbërta.

Organizma të tillë si AICS (Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo), e cila ofron mbështetje nëpërmjet zbatimit të projektit “RISE-ALB: Forcimi i Sipërmarrjes Sociale në Shqipëri”.

### YSB Balkans

Filloi si një projekt për zhvillimin e biznesit social në Shqipëri në qershor të vitit 2012 dhe më pas u regjistrua zyrtarisht në shkurt të vitit 2013 si OJF.

YSB Balkans mbështet sipërmarrësit dhe zhvillimin e sektorit gjithëpërfshirës të sipërmarrjeve sociale në rajon.

Vizioni i tij është që sipërmarrësit në vendet e Ballkanit Perëndimor të fuqizohen për të ndërmarrë veprime të guximshme dhe për të sjellë ndryshime të rëndësishme pozitive në shoqëri.

[8] Faqja zyrtare web e Dua Partner Invest: <https://www.duapartnerinvest.com/homepage>

[9] Faqja zyrtare web e Yunus Social Business Balkans: <https://www.balkanimpact.com/about-us>

[10] Faqja zyrtare web e Growpreneur: <https://growpreneur.al/>

[11] Faqja zyrtare web e UPSHIFT: <https://upshift.al/>



Ka edhe organizata të tjera mbështetëse, të konsideruara si Lehtësues, që mbështesin ekosistemin e sipërmarrjes, duke përfshirë edhe ofrimin e mbështetjes për inovatorët e rinj, sipërmarrësit, bizneset e reja dhe individët me ide biznesi, që operojnë në fusha të ndryshme dhe nuk fokusohen në mënyrë specifike në sipërmarrjen sociale. Në këtë kategori përfshihen: ICTS Lab përmes programit të përsheptimit Uplift Albania dhe UPSHIFT[11], Tirana Inc., Inkubatori i Biznesit Studentor nga TBU, Destil Creative Hub, Argjiro Innovation Hub, Barleti Hub, Innohub, Coolab, Oficina, Swisscontact Albania, Talent Garden, Center for Competitiveness Promotion, Protik Innovation Center Albania, Women Founders Albania, Innovation Factory në Universitetin Polis, and Triple City.

## UPSHIFT

UPSHIFT është një program që ndihmon adoleshentët dhe të rinjtë të bëhen inovatorë dhe sipërmarrës socialë, duke u ofruar mësim praktikë për të kuptuar sfidat e komunitetit. Të rinjtë mësojnë të projektojnë dhe ndërtojnë zgjidhje në formën e produkteve apo shërbimeve dhe angazhohen në ngritjen e sipërmarrjeve që mundësojnë zhvillimin e këtyre projekteve.

### Institucionet qeveritare:

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ofron fonde nëpërmjet granteve për startup-et që kanë në fokus të tyre gratë, të rinjtë, artizanët, etj.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përgjegjëse për dhënien e statusit të NS-ve, është përgjegjëse për administrimin e regjistrimit të NS-ve që kanë marrë statusin, si dhe për administrimin e fondit shtetëror për këto NS, parashikuar nga VKM "Për Themelimin të Fondit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve Sociale dhe Formularët e Mbështetjes nga Filialet për Ndërmarrjet Sociale".

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, bazuar në ligjin e ri të miratuar "Për mbështetjen dhe zhvillimin e Start-up-ve", ka shpallur skemën e grantit prej 10 milionë euro, në mbështetje të Start-upeve dhe Lehtësuesve të ekosistemit të sipërmarrjes, ndonëse siç u përmend më lart, ky fond nuk synon në mënyrë specifike mbështetjen për SS-të.

Në nivel vendor, Bashkia e Tiranës ka shpallur thirrje të ndryshme dhe ka zbatuar projekte të ndryshme që nuk synojnë drejtpërdrejt SS-të, por që synojnë fuqizimin e grupeve vulnerabël dhe rritjen e ofrimit të mundësive për punësim, të tillë si projekti "Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes"[12] dhe projekti "Fuqizimi i të Rinjve dhe të Rejave" [13] gjithashtu në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm.

### Institucionet financiare:

Fondi Evropian i Investimeve (EIF) dhe institucioni mikrofinanciar BESA kanë krijuar një instrument për punësimin dhe zhvillimin e inovacionit social të ndërmarrjeve të vogla. Gjatë viteve të fundit, Banka Credins ka mbështetur me financim fillestar start-upe të gjelbërta në bashkëpunim me Partnerët Shqipëri. Tirana Bank i është bashkuar së fundmi nismës, duke mbështetur Konkursin Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta të vitit 2022.

[11] Faqja zyrtare web e UPSHIFT: <https://upshift.al/>

[12] <https://tirana.al/artikull/fuqizimi-i-grave-dhe-nxitja-e-sipermarrjes>

[13] <https://tirana.al/artikull/projekti-i-bashkise-tirane-per-fondin-e-fuqizimit-te-te-rinjve-dhe-te-rejave>

## 2.3. Sfidat dhe mundësitë për SS-të duke marrë në konsideratë kontekstin dhe kushtet në fushën/vendin e tyre të veprimit.

### Sfida:

Sektori i SS-së është ende në fazat e tij të hershme në Shqipëri, duke qenë se pjesa më e madhe e sipërmarrjeve sociale janë krijuar në dekadën e fundit. Sipërmarrjet Sociale dhe aktorët e këtij sektori po përballen me shumë sfida dhe rruga drejt arritjes së qëndrueshmërisë është e gjatë. Sfidat kryesore janë:

**Mungesa e kapaciteteve menaxhuese sipërmarrëse të Sipërmarrësve Socialë.** Deri më tani, shumica e Sipërmarrjeve Sociale janë krijuar nga OSHC-të, të cilave u mungon mendësia sipërmarrëse për të operuar në treg. Në shumicën e rasteve, këto SS trajtojnë një çështje specifike sociale ose krijojnë një impakt social për grupin e tyre të synuar ose komunitetin ku veprojnë, duke u përqendruar në arritjen e misionit të tyre social. Atyre u mungon koordinimi ndërmjet misionit social dhe qasjes ndaj menaxhimit të biznesit, të dyja këto të pranishme në sipërmarrjet tradicionale.

**Mungesa e informacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kryesorë.** Siç u përmend, numri i aktorëve të përfshirë në ekosistem është ende i ulët dhe pjesa më e madhe e mbështetjes vjen nga organizatat jofitimprurëse që kanë një fokus të qartë në zhvillimin e sektorit të SS-së ose që mbështesin SS-të përmes mekanizmave të ndryshëm mbështetës. Vihet re një mungesë e konsiderueshme për sa i përket iniciativave midis aktorëve dhe grupeve të interesit, vullnetit për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin, pavarësisht se janë bërë përpjekje për krijimin e një diskutimi publik dhe ngritjen e strukturave advokuese (ad-hoc), si ajo e ligjit për ndërmarrjet sociale.

**Mungesa e kuadrit ligjor për SS-të.** Në ligjin nr. 65/2016 për Ndërmarrjet Sociale, vihet re një kufizim në përkufizimin (përcaktimin) e Sipërmarrjes Sociale në Shqipëri. Pavarësisht se funksionojnë si Ndërmarrje Sociale, subjektet që kanë një fokus të qartë në aspektin social, ende nuk mund të përfitojnë nga ky ligj dhe pajisja me statusin e "Ndërmarrjes Sociale" sipas këtij ligji. Po ashtu, ekziston një mungesë qartësisht në lidhje me përfitimet që ka subjekti pas marrjes së statusit të "Ndërmarrjes Sociale", të miratuar nga MShMS. Kjo paqartësi pasohet nga mungesa e mekanizmave mbështetës për SS-të. Subjektet që janë në proces të marrjes së statusit të "Ndërmarrjes Sociale", apo ato që u është dhënë ky status, janë ende të paqarta për përfitimet e ofruara, apo proceset se si të mund të jenë pjesë e këtyre përfitimeve.

**Mungesa e ndërgjegjësimit dhe mbështetjes nga vetë grupet kryesore të synuara të SS-ve dhe komuniteti më i gjerë i aktorëve.** Një prej sfidave kryesore me të cilat përballen SS-të është mungesa e ndërgjegjësimit për sa i përket produkteve dhe shërbimeve që këto të fundit ofrojnë, si dhe për sa i përket grupit të synuar që po përpiqen të mbështesin me të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti ekonomik i sipërmarrjes. Shpeshherë, mungesa e mbështetjes vjen edhe nga vetë grupi kryesor i synuar i SS-së, i cili në shumicën e rasteve përfshin grupet e pafavorizuara dhe familjet e tyre. Po kaq e vështirë është edhe marrja e përkrahjes së tyre në mbështetje të aktivitetit të SS-ë.

**Sfidat në lidhje me qëndrueshmërinë financiare.** Deri më tani, grantet e ofruara nëpërmjet programeve apo projekteve të ndryshme dhe donacionet kanë shërbyer si mbështetja kryesore financiare për SS-të. Mungojnë mekanizmat e tjerë mbështetës, tashmë ekzistues në vende të tjera, si engjëjt e biznesit apo kapitalet sipërmarrëse, ndërkohë që alokimi i mbështetjes financiare nga shteti (fondi për ndërmarrjet sociale) ka rezultuar jo efektiv. Në këtë drejtim, mbështetja nuk duhet të kufizohet vetëm në grante, por duhet të përgatitet një plan afatmesëm i qartë që mbulon zhvillimin e mëtejshëm të SS-ve dhe funksionimin e tyre në treg.



**Mungesa e një programi studimi të dedikuar për Sipërmarrjen Sociale.** Pavarësisht nismave të zbatuara nga aktorë të veçantë për realizimin e kërkimeve apo ofrimin e programeve të zhvillimit të kapaciteteve për sa i përket sektorit të Sipërmarrjeve Sociale, në Shqipëri mungon një program studimi i përshtatur dhe i miratuar në nivel universiteti për Sipërmarrjen Sociale. Siç u përmend, ka disa universitete që kanë përfshirë në kurrikulën e tyre kurse për ekonominë sociale, sipërmarrjen dhe inovacionin, por që nuk kanë një program të dedikuar për Sipërmarrjen Sociale.

## Mami Care

### ***"Qëllimi është të mbështesim çdo nënë gjatë dhe pas shtatzënisë"***

"Mami Care" filloi të funksionojë në vitin 2012, si një qendër fitnesi, edukative dhe komunitare për prindërit e rinj. Ajo u krijua si një alternativë mbështetëse dhe burim financimi për Fondacionin Spitalor i Nënës dhe Fëmijës, duke e ndihmuar atë të vazhdojë punën dhe arritjen e misionit të tij drejt mbështetjes së çdo nënë gjatë dhe pas shtatzënisë. Fondacioni Spitalor i Nënës dhe Fëmijës është një OJQ e themeluar në Tiranë, me synimin për të mbështetur maternitetet në Shqipëri për të siguruar mirëqenien e të porsalindurve dhe grave në nevojë duke optimizuar kujdesin shëndetësor, sigurinë dhe komoditetin e pacientëve. Puna e fondacionit ka një fokus të veçantë tek gratë që i përkasin grupeve më vunerabël dhe foshnjat e tyre[14] Në kuadër të projektit EMBRACE të zbatuar nga Partnerët Shqipëri, Mami Care ka perfituar një grant në shumën 7,000 euro[15].

### **Përshkrimi i SS-së**

"Mami Care" funksionon si një qendër komunitare ku prindërit e rinj dhe ata në pritje takohen, marrin pjesë në klasat e para dhe pas lindjes të udhëhequra nga ekspertë, si dhe shkëmbejnë praktika. Ai ofron mundësi punësimi për pesë gra. Disa janë gjithashtu të angazhuara në baza vullnetare, ose me kohë të pjeshme, duke e ndarë punën brenda aktiviteteve të Fondacionit ose aktiviteteve të SS-së.

Grupet e synuara dhe klientët në të njëjtën kohë janë nënat dhe baballarët e rinj dhe ata që presin të bëhen të tillë. Shërbimet kryesore të ofruara përfshijnë: klasat (kurse) para lindjes dhe mbështetje që ofrohet në shtëpi pas lindjes e quajtur "Mami at home" që lidhet me ofrimin e ndihmës për nënat në ditët e para pas lindjes; shërbimin dhe mbështetjen në lidhje me çështjen e ushqyerjes me gji; trajnime online për çështje të tjera specifike. Përballja me pandeminë Covid-19 ishte e vështirë dhe qendrës Mami Care iu desh t'i nënshtrohej një procesi rinovimi, për të përballur sfidat.

### **Angazhimi dhe Mbështetja e SS-ë për Sektorët e Varfërisë**

Të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet e ofruara nga Mami Care përdoren për të mbështetur nënat e varfëra dhe ato që vijnë nga grupet e tjera të pafavorizuara në spitalet shtetërore, të cilat nuk kanë mundësi të paguajnë për këto shërbime të nevojshme.

[14] <https://fsnf.org/index.html>

[15] <https://partnersalbania.org/embrace-entrepreneurship-models-building-relations-and-creative-economy/>

### **Përparësitë dhe Kufizimet e Angazhimit dhe Mbështetja e SE-së për Sektorët e Varfërisë**

Mami Care synon të edukojë nënat dhe t'i fuqizojë ato, duke ofruar gjithashtu për to dhe foshnjat e tyre një kujdes më të mirë. Një prej shtyllave kryesore është zbatimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere online, duke patur parasysh mungesën e një hapësire fizike të dedikuar për të ofruar klasa/kurse. Ky shërben edhe si një prej kufizimeve të ofrimit të shërbimit. Një kufizim tjetër i atribuohet numrit të ulët të stafit të angazhuar dhe mungesës së aktiviteteve shtesë në funksion të marketingut dhe promovimit.

### **Fitimet dhe përfitimet e nxjerra nga Sektorët e Varfërisë**

Përfitimi kryesor nga aktiviteti sipërmarrës lidhet me nënat, të cilat kane një kuptim më të gjerë mbi trupin dhe shëndetin e tyre dhe të foshnjave të tyre. Përveç kësaj, ato ndihen të vlerësuara nga mënyra se si ofrohet shërbimi dhe kujdesi ndaj tyre, veçanërisht lidhur me problematika të ndryshme të hasura në këtë fazë, si stresi pas lindjes dhe çështjet e ushqyerjes me gji.

Në të ardhmen, Mami Care synon të ofrojë shërbime të drejtpërdrejta edhe për gratë që vijnë nga sektorët e varfërisë.

### **Angazhimi aktual me organizatat qeveritare, OSHC-të dhe organizatat e tjera**

Deri tani janë krijuar mundësi bashkëpunimi me biznese që ofrojnë mallra dhe produkte për foshnjat dhe nënat, në këmbim të aktiviteteve të marketingut dhe promovimit. Disa raste përfshijnë aktorë si BioSafe, Chicco dhe FiBank.

Po ashtu, janë bërë përpjekje për të krijuar bashkëpunime me institucionet shtetërore për të mundësuar shtrirjen e shërbimeve në qendrat aktive të kujdesit në të gjithë vendin, duke pasur parasysh gjithashtu se shërbimet e ofruara nga Mami Care duhet të ofrohen nga institucionet shtetërore.



Pavarësisht sfidave me të cilat përballen Sipërmarrjet Sociale dhe aktorët e tjerë të sektorit të SS-ve, ekzistojnë disa mundësi, të përmendura edhe nga intervistuesit, që lehtësojnë në një farë mase funksionimin e këtyre SS-ve, të renditura më poshtë:

**Konsiderimi si një sektor i ri dhe që vepron në një territor të paeksploruar**, shihet si një mundësi për SS-të e reja të krijuara dhe ato në zhvillim, për të qenë të suksesshme në sektorët e tyre të operimit, si dhe për të përdorur mënyra kreative dhe ofruar zgjidhje novatore ndaj problemeve të hasura nga grupet e tyre të synuara.

**Ekzistenca e mekanizmave mbështetës financiarë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë**, që gjejnë zbatim edhe për SS-të. Mekanizmat e ndryshëm mbështetës financiarë që janë në dispozicion nga institucionet shtetërore dhe ato jo-shtetërore, nuk paraqesin asnjë kufizim dhe as i ndalojnë SS-të të aplikojnë dhe të përfitojnë prej tyre. Programet që janë aktualisht në fuqi dhe janë duke u zbatuar, lejojnë sipërmarrjet ekzistuese sociale të marrin pjesë dhe të konkurrojnë duke ndjekur të njëjtat rregulla si dhe format e tjera të sipërmarrjeve.

**Ekzistenca e programeve dhe organizatave që ofrojnë mbështetje teknike dhe ngritje kapacitetesh**, kryesisht përmes programeve të përshpejtimit, inkubimit dhe zhvillimit të Start-up-eve. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në studim përmendën ekzistencën e programeve, nismave apo projekteve që synojnë të mbështesin sipërmarrjen dhe ekosistemin e saj, të cilat mund të shërbejnë edhe si një mundësi për sipërmarrjet sociale, duke marrë në konsideratë që në këto programe nuk ka diferencime në kriteret e ofrimit të mbështetjes, pra për sa i përket aplikimit të kriterëve përjashtuese specifikisht për sipërmarrjet sociale.

**Ekzistenca e një diskursi publik për të rritur ndërgjegjësimin mbi potencialin e SS-ve**, të zhvilluara kryesisht nga OSHC-të e fokusuara në zhvillimin e aktivitetit të sipërmarrjeve sociale. Mundësitë shihen në punën e aktorëve të ekosistemit të cilët po kontribuojnë në zhvillimin e këtij sektori, si Partnerët Shqipëri, Yunus Social Business, apo Inkubatori RISE.

**Mundësitë për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer përvoja me ekonomitë me një stad të avancuar të sektorit të SS-ve**, nëpërmjet zbatimit të programeve dhe projekteve të përbashkëta me aktorët rajonalë. Të intervistuarit përmendën në mënyrë specifike ekosistemin italian dhe aktivitetet që mund të zbatohen si pjesë e projekteve dhe nismave ndërkufitare ose rajonale.

## 2.4. Potencialet për bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve dhe SS-ve në Advokimin për Zhvillimin e Bashkëpunimit

Duke marrë në konsideratë stadin e zhvillimit të SS-ve në Shqipëri, vërehet potencial për bashkëpunim ndërmjet grupeve të aktorëve kryesorë dhe SS-ve, si një mënyrë për të avancuar më tej në këtë fazë. Pjesa më e madhe e SS-ve janë krijuar si iniciativa që vijnë nga OSHC-të, me synim përmbushjen e misionit të tyre social, dhe si e tillë, kjo paraqitet si një mundësi për të angazhuar të dy sektorët (OSHC-të dhe SS-të), për të krijuar një agjendë të përbashkët për zhvillimin e bashkëpunimit. Disa nga hapat që duhet të merren parasysh për të shfrytëzuar plotësisht këtë potencial janë:

- Rritja e vazhdueshme e ndërgjegjësimit, shkëmbimi i informacionit dhe njohurive në lidhje me konceptet e sipërmarrjes sociale, terminologjinë e përdorur dhe fushat e veprimit. Në këtë mënyrë, do të ishte më i lehtë bashkëpunimi ndërmjet OSHC-ve që janë të angazhuara ose planifikojnë të angazhohen në aktivitete sipërmarrëse sociale, si dhe ndërmjet OSHC-ve që mbështesin SS-të dhe aktorëve të tjerë nga sektori publik dhe privat, duke çuar kështu në krijimin e një strategjie për të mbështetur SS-të, duke përfshirë krijimin e mekanizmave të rinj mbështetës.
- Identifikimi i fazave të zhvillimit të SS-ve në vende të tjera në nivel evropian, praktikave më të mira dhe krijimi i mundësive të bashkëpunimit, si një mënyrë për të zbatuar këto praktika në Shqipëri, duke marrë parasysh sektorët e zhvillimit ekonomik në Shqipëri dhe fokusin e zhvillimit për një periudhë afatgjatë. Rastet e vogla duhet të nxiten dhe të mbështeten më tej për të arritur fazën e dëshiruar të zhvillimit, përmes programeve të përbashkëta rajonale, projekteve dhe krijimit të mundësive të rrjetëzimit.
- Angazhimi kuptimplotë i institucioneve përgjegjëse qeveritare në tryeza të rumbullakëta dhe takime konsultuese me SS-të dhe OSHC-të, veçanërisht përfaqësuesit e sipërmarrjeve sociale, për të diskutuar rreth zhvillimit të sektorit të SS-së, kornizës ligjore që rregullon sektorin, dhe mekanizmave financiarë dhe të tjerë mbështetës.
- Krijimi dhe forcimi i bashkëpunimit ekzistues midis SS-ve dhe OSHC-ve me strukturat shtetërore përgjegjëse për punësimin, në nivel vendor dhe kombëtar, si Zyrat Rajonale të Punësimit, Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe sektori privat, me qëllim identifikimin dhe krijimin e mundësive për fuqizimin dhe punësimin e grupeve të marginalizuara.

# 3. Konkluzion dhe Rekomandime

## 3.1. Konkluzion

Ekonomia Sociale dhe Ndërmarrjet Sociale janë koncepte ende të reja në Shqipëri, për të cilat është e domosdoshme përpjekja dhe mbështetja e koordinuar për të gjithë aktorët e përfshirë, dhe strategji të synuara që përfshijnë ndërgjegjësimin, ngritjen e kapaciteteve, programet arsimore, financiare dhe mekanizma të tjerë mbështetës, për të kaluar nga faza e hershme e zhvillimit në një nivel më të avancuar të qëndrueshëm që prodhon një ndikim më të madh social, duke qenë ky objektivi kryesor i sipërmarrjeve sociale. Si një prioritet strategjik në këtë drejtim duhet konsideruar edhe ngritja e një kuadri ligjor dhe rregullator mundësues, i zhvilluar përmes një procesi pjesëmarrës me përfshirjen e aktorëve kryesorë

## 3.2. Rekomandime

Strategjitë dhe veprimet kryesore që do të shërbenin për adresimin e sfidave dhe mbështetjen e zhvillimit të sektorit të SS-ve në Shqipëri janë:

**Krijimi i një kuadri ligjor dhe rregullator për SS-të.** Për të mundësuar këtë është e nevojshme ngritja e një grupi pune të përbërë nga përfaqësues të aktorëve kryesorë të ekosistemit si OSHC-të, SS-të, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe agjencitë e tjera shtetërore përkatëse, përfaqësues nga sektori privat, universitetet dhe palë të tjera të interesuara të identifikuar. Synimi duhet të jetë diskutimi i hendeqeve dhe propozimi i ndryshimeve në mekanizmat ekzistues ligjorë dhe rregullatorë për të mbështetur funksionimin e të gjitha formave të sipërmarrjeve sociale, duke ditur njohur diversitetin e tyre, që plotësojnë tre dimensionet kryesore: qeverisjen sociale, ekonomike dhe atë me pjesëmarrje.

**Krijimi i një ekosistemi të konsoliduar në mbështetje të SS-ve në vend,** nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit dhe rrjetëzimit ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në zhvillimin e SS-ve, nëpërmjet përpjekjeve të koordinuara, planeve dhe strategjive të qarta të veprimit. Zhvillimi i diskutimeve publike, organizimi i tryezave të rrumbullakëta dhe angazhimi i palëve të interesuara do t'i shërbente gjithashtu qëllimit të adresimit të sfidave kryesore dhe ofrimit të zgjidhjeve për problematikat e identifikuar.

**Krijimi i një mjedisi mundësues për mekanizma të ndryshëm financiarë shtetërorë dhe jo-shtetërorë dhe mekanizma të tjerë mbështetës për OSHC-të për të rritur qëndrueshmërinë financiare të SS-ve.** Përvoja ndërkombëtare tregon se SS-të janë shumë të varura nga financimi publik, kontratat sociale dhe mbështetjet e tjera shtetërore. Për këtë arsye qeveria shqiptare duhet të zgjerojë mundësitë e financimit për SS-të. Do të duhet të ndërmerren veprime konkrete, qoftë për të përmendur SS-të në mënyrë specifike si përfituese të mekanizmave ekzistues mbështetës, si në rastin e grantit të akorduar për zhvillimin e startup-eve, ose fondet e akorduara nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, etj., qoftë nëpërmjet prokurimit të shërbimeve sociale nga institucionet publike në nivel vendor dhe qendror përmes SS-ve, siç parashikohet në ligjin për prokurimin, etj. Projektimi dhe shpërndarja e fondit për ndërmarrjet sociale duhet gjithashtu të rishikohet për të qenë i aksesueshëm dhe për t'iu përgjigjur nevojave të SS-ve. Gjithashtu, duhet të futet dhe inkurajohet bashkë-projektimi i shërbimeve ndërmjet SS-ve dhe qeverisë. Mekanizma të tjerë financiarë jo-shtetërorë, si “engjëjt e biznesit”, investimet me impakt social, etj., duhet gjithashtu të promovohen dhe nxiten.

**Hartimi dhe prezantimi i një kurrikule arsimore për ekonominë sociale dhe sipërmarrjen sociale në nivel universitar.** Ky shërben si një rekomandim strategjik për të motivuar dhe angazhuar të rinjtë në fushën e inovacionit dhe sipërmarrjes, përmes metodave të edukimit formal dhe informal, të ofruara në universitete, duke pasur si grup të synuar sipërmarrësit e mundshëm socialë dhe inovatorët socialë. Programi mund të shtrihet edhe tek sipërmarrësit socialë ekzistues për të rritur kapacitetet e tyre në menaxhimin e sipërmarrjeve sociale, veçanërisht në tema që lidhen me kërkimin e tregut, menaxhimin financiar, menaxhimin e riskut, kuadrin ligjor, integrimin e teknologjisë në shërbime, etj.



# Referenca

Komisioni Evropian (2019) Ndërmarrjet sociale dhe ekosistemet e tyre në Evropë. Kapitulli për Shqipërinë. Autorë: Ariola Agolli, Eriola Haska, Juliana Hoxha. Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian. Në dispozicion në <https://europa.eu/!Qq64ny>

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2019). Analiza e Kuadrit Ligjor për Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri: <https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Analyses-of-legal-framework-on-social-enterprises-in-Albania.pdf>

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2019). Paketa Ligjore për Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri: <http://partnersalbania.org/programs/evidence-based-advocacy-for-advancing-the-legal-and-regulatory-framework-in-support-of-entrepreneurship-and-social-risi/>

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2019). Ndërmarrjet Sociale dhe ekosistemet e tyre në Evropë. Kapitulli për Shqipërinë.

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2020). Karakteristikat dhe Sfidat e Ndërmarrjeve Sociale në Shqipëri (Bot. Studimi Bazë). Tiranë, Shqipëri.

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2021). Një kornizë e mjeteve financiare dhe mbështetëse për rritjen e bizneseve fillestare.

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2021). Kontributi i Partnerëve Shqipëri në ekosistemin e Start-up-ve të Gjelbër dhe Ndërmarrjeve Sociale.

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2021). Ekonomia Sociale midis të rinjve në Shqipëri: Praktikrat dhe rekomandimet më të mira të korrjes.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Republikën e Shqipërisë (2021-2025).

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2022). Udhërrëfyeni i Ekosistemit të Sipërmarrjes së Gjelbër në Ballkanin Perëndimor. Shteti: Shqipëri.



# Shtojcat

## Shtojca 1 – Aktorët kryesorë të Angazhuar në Studim

**Matrica 1: Aktorët kryesorë të angazhuar në studim**

Nr./ ID	Kategoria	Tipi	Informatori kyç
1	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Me status të NS-ve	Klubi Kombëtar i Prindërve të Fëmijëve me ÇSA (Çrregullime të Spektrit Autik)
2	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Me status të NS-ve	Shoqata shqiptare për edukim, përkujdesje dhe trajnim (ACT-Center)
3	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Me status të NS-ve	Shoqata "Fuqizimi i Grave të Liqenit të Shkodrës" F.G.L.SH
4	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Me status të NS-ve	Shoqata Kombëtare për Integrim, Zhvillim dhe Ndihmë për Shtresat në Nevojë (SHKIZH)
5	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Me status të NS-ve	Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV)
6	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Mbështetur nga programet (Green Ideas & Start-up City)	Romix Community Comics
7	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Mbështetur nga programet (EMBRACE)	Mami Care Center – Fondacioni Spitalor i Nënës dhe Fëmijës
8	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Mbështetur nga programet (EMBRACE)	Te Xhoni Café - Qendra Jonathan
9	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Mbështetur nga programet (DIVAC)	Drita Cleaning - Voice of Roma
10	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Mbështetur nga programet (EMBRACE & Green Ideas)	App Tour - Vjosa Explorer
11	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Mbështetur nga programet (EMBRACE)	Made in Prison - Organizata Orkidea Tiranë
12	1. Udhëheqësit kryesorë të SS-ve	Mbështetur nga programet (EMBRACE)	Qendra Rinore Arka - Code Partners Shkodra

13	2. Institucionet qeveritare (shtetërore) burimore të SS-ve	Qeveria, privat	OSHC-të,	sektori	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
14	2. Institucionet qeveritare (shtetërore) burimore të SS-ve	Qeveria, privat	OSHC-të,	sektori	Bashkia Tiranë: Drejtoria e Punësimit
15	2. Institucionet qeveritare (shtetërore) burimore të SS-ve	Qeveria, privat	OSHC-të,	sektori	Bashkia Tiranë: Drejtoria e Investimeve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik
16	2. Institucionet qeveritare (shtetërore) burimore të SS-ve	Qeveria, privat	OSHC-të,	sektori	Bashkia Tiranë: Projekti për Fuqizimin e Grave, Projekti për Fuqizimin e të Rinjve
17	2. Institucionet qeveritare (shtetërore) burimore të SS-ve	Qeveria, privat	OSHC-të,	sektori	Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

18	3. Ekspertët nga fusha akademike	Organizatat Mbështetëse			Universiteti Metropolitan Tirana
19	3. Ekspertët nga fusha akademike	Organizatat Mbështetëse			Universiteti Metropolitan Tirana
20	3. Ekspertët nga fusha akademike	Organizatat Mbështetëse			Universiteti Epoka
21	4. Institucion/organizatë financiare e SS-ve	Organizatat Mbështetëse			Tirana Bank
22	4. Institucion/organizatë financiare e SS-ve	Organizatat Mbështetëse			Credins Bank
23	5. Aktorët në fushën e kërkimit, zhvillimit të kapaciteteve ose ofruesit e teknologjisë për SS-të	Organizatat Mbështetëse			BC Business Consultancy
25	7. Agjencitë shumëpalëshe të zhvillimit që mbështesin SS-të	Organizatat Mbështetëse			UN Women
26	7. Agjencitë shumëpalëshe të zhvillimit që mbështesin SS-të	Organizatat Mbështetëse			UNDP

24	6. Rrjetet e SS-ve ose rrjetet/platformat shumëpalëshe që promovojnë SS-të	Rrjetet SS-ve, platformat shumëpalëshe			Yunus Social Business Balkans
28	9. SS-të rajonale ose globale ose institucionet burimore të SS-ve në vendet ku është zhvilluar studimi	Rrjetet SS-ve, platformat shumëpalëshe			Inkubatori RISE (Regional Incubator for Social Entrepreneurs)

# Shtojca 2 – Matricat: Pyetjet kryesore kërkimore për të intervistuarit kyç nga sektori i SS-ve

## Matrica 2: Pyetjet kryesore të kërkimit për institucionet burimore të SS-ve

Objektivat e Kërkimit	Pyetjet kryesore
<p>Fusha e veprimit e Agjencisë Shtetërore / Institucionit</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Cili është mandati i zyrës / organizatës / institucionit tuaj? Cilat programe dhe shërbime specifike zbatoni për Sipërmarrjet Sociale (SS)?</li> <li>2. Cilat janë pikat e forta dhe kufizimet e këtyre programeve dhe shërbimeve?</li> <li>3. Cilat mendoni se kanë qenë përfitimet e SS-ve nga këto programe dhe shërbime?</li> <li>4. Në cilat fusha mendoni se zyra/organizata/institucioni juaj mund të kontribuojë për të mbështetur më tej SS-të dhe sektorin e SS-së në Shqipëri? Cilat janë planet tuaja në këtë drejtim?</li> </ol> <p><u>Për ekspertët nga Akademia</u> - Cilat kërkime/studime mund të rekomandoni për të kuptuar më mirë sektorin e SS-ve në Shqipëri?</p> <p><u>Për Agjencitë Shumëpalëshe të Zhvillimit që mbështesin SS-të</u> - Pse i mbështet agjencia/institucioni juaj SS-të? - Cilat janë sfidat e hasura gjatë punës për mbështetjen e SS-ve?</p> <p><u>Për organizatat e lidhura me lëvizjet globale të SS-ve</u> - Si i ka mbështetur SS-të dhe sektorin e SS-ve në Shqipëri lidhja që ju keni krijuar me lëvizjet globale të SS-ve?</p>
<p>Identifikimi i aktorëve kryesore në sektorin e SS-ve, të cilët janë angazhuar ose mund të angazhohen në zhvillimin e advokimit për bashkëpunim</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. A mund të identifikoni disa SS në Shqipëri të cilat mendoni se kanë qenë të suksesshme në gjenerimin e të ardhurave për të përmbushur/mbështetur misionin e tyre social? Cila prej tyre (këtyre SS-ve):             <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1. Përfshin të varfrit si furnitorë, të varfrit si punonjës (punëtorë), apo të varfrit si klientë?</li> <li>1.2. Është organizatë jo-fitimprurëse, kooperativë, apo ndërmarrje sociale?</li> <li>1.3. Vazhdimisht përqendrohet në fuqizimin ekonomik të grave (FEG)?</li> </ol> </li> <li>2. A mendoni se këto SS janë të gatshme për të bashkëpunuar me SS, OJF dhe organizata të tjera mbështetëse për të advokuar për të marrë më shume mbështetje për sektorin e SS-ve dhe të grupeve të varfra të cilave ato u shërbejnë?</li> <li>3. A mund të identifikoni organizata (institucione) të tjera shtetërore, jo-qeveritare, apo të sektorit privat në Shqipëri, të cilat ofrojnë mbështetje financiare dhe/ose teknike për SS-të? Cila është mbështetja/shërbimet e tyre specifike?</li> <li>4. A njihni një rrjet apo platformë bashkëpunuese të SS-ve në Shqipëri? Çfarë bëjnë ata përgjithësisht për sektorin e SS-ve?</li> </ol>

<p>Përcaktimi i sfidave dhe mundësive për SS-të, duke u nisur nga konteksti dhe kushtet e vendit të tyre të operimit (Shqipërisë)</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Cilat janë çështjet dhe sfidat me të cilat përballen SS-të në Shqipëri? Cilët faktorë/rrethana pengojnë zhvillimin e tyre? Çfarë veprimesh po merren për të adresuar këto çështje dhe sfida?</li> <li>2. Nga ana tjetër, cilat janë mundësitë për SS-të në Shqipëri? Cilët faktorë/rrethana lehtësojnë zhvillimin e tyre? Si po shfrytëzohen këto mundësi nga SS-të?</li> </ol>
<p>Zbulimi i strategjive dhe rekomandimeve mbi mënyrat se si OSHC-të dhe aktoret kryesore të SS-ve mund të bashkëpunojnë për të mbështetur më tej dhe zhvilluar sektorin e SS-ve, si një prej kontribuuesve kryesorë në zhvillimin e qëndrueshëm.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. A njihni ndonjë rrjet apo platformë bashkëpunuese, si të SS-ve, ashtu edhe të OSHC-ve në Shqipëri? Cilat janë objektivat e tyre kryesore dhe çfarë është përfituar/arritur nga puna e tyre?</li> <li>2. A mund të mendoni mbi disa mënyra se si OSHC-të mund të bashkëpunojnë me SS-të për të adresuar sfidat me të cilat SS-të përballen në Shqipëri?</li> <li>3. Si mendoni se SS-të mund të mbështeten më mirë nga zyra/organizata juaj? Nga qeveria? Nga institucionet burimore (agjencitë donatore, institucionet akademike, OSHC-të, etj.)?</li> <li>4. Si mund të bashkëpunojnë SS-të dhe OSHC-të për të nxitur/zhvilluar rolin e SS-ve si aktorë ndikues në zhvillimin e qëndrueshëm?</li> <li>5. Si mund të bashkëpunojnë SS-të dhe OSHC-të për të ndikuar në zhvillimin e diskutimeve bashkëpunuese (asistenca zhvillimore bilaterale dhe multi-laterale, remitancat, mobilizimi i burimeve vendase, etj.) në fuqizimin e rolit të SS-ve si aktorë, dhe të sipërmarrjes si një mënyrë/qasje e zhvillimit të qëndrueshëm?</li> </ol>



### Matrica 3: Pyetjet kryesore të kërkimit për rrjetin e SS-ve

Objektivat e Kërkimit	Pyetjet Kryesore
Fusha e veprimit të Rrjetit të SS-ve	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në cilin vit u themelua Rrjeti? Cilat ishin rrethanat që çuan në krijimin e tij? Ju lutemi, përshkruani me detaje fillimin e Rrjetit.</li> <li>2. Cila është agjenda e advokimit të Rrjetit tuaj? Deri në çfarë mase është realizuar/shtyrë kjo agjendë?</li> <li>3. Cilat janë programet dhe aktivitetet aktuale të Rrjetit, në mbështetje të kësaj agjende? Çfarë shërbimesh specifike u ofroni anëtarëve të rrjetit?</li> <li>4. Cilat janë pikat e forta dhe kufizimet e këtyre programeve dhe aktiviteteve?</li> <li>5. Cilat mendoni se kanë qenë përfitimet e anëtarëve dhe të sektorit të SS-ve nga këto programe dhe aktivitete?</li> </ol>
Identifikimi i aktorëve kryesore në sektorin e SS-ve, të cilët janë angazhuar ose mund të angazhohen në zhvillimin e advokimit për bashkëpunim	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. A mund të identifikoni disa SS në Shqipëri të cilat mendoni se kanë qenë të suksesshme në gjenerimin e të ardhurave për të përmbushur/mbështetur misionin e tyre social?</li> <li>2. A mendoni se këto SS janë të gatshme për të bashkëpunuar me rrjetin tuaj, SS, OJF dhe organizata të tjera mbështetëse për të advokuar për të marrë më shumë mbështetje për sektorin e SS-ve dhe të grupeve të varfra të cilave ato u shërbejnë?</li> <li>3. A mund të identifikoni organizata (institucione) të tjera shtetërore, jo-qeveritare, apo të sektorit privat në Shqipëri, të cilat ofrojnë mbështetje financiare dhe/ose teknike për SS-të? Cila është mbështetja/shërbimet e tyre specifike?</li> </ol>
Përcaktimi i sfidave dhe mundësive për SS-të, duke u nisur nga konteksti dhe kushtet e vendit të tyre të operimit (Shqipërisë)	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Cilat janë çështjet dhe sfidat me të cilat përballen SS-të në Shqipëri? Cilët faktorë/rrethana pengojnë zhvillimin e tyre? Çfarë veprimesh po merren për të adresuar këto çështje dhe sfida?</li> <li>2. Nga ana tjetër, cilat janë mundësitë për SS-të në Shqipëri? Cilët faktorë/rrethana lehtësojnë zhvillimin e tyre? Si po shfrytëzohen këto mundësi nga SS-të?</li> </ol>
Zbulimi i strategjive dhe rekomandimeve mbi mënyrat se si OSHC-të dhe aktorët kryesore të SS-ve mund të bashkëpunojnë për të mbështetur më tej dhe zhvilluar sektorin e SS-ve, si një prej kontribuuesve kryesorë në zhvillimin e qëndrueshëm.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. A njihni ndonjë rrjet apo platformë bashkëpunuese, si të SS-ve, ashtu edhe të OSHC-ve në Shqipëri? Cilat janë objektivat e tyre kryesore dhe çfarë është përfituar/arritur nga puna e tyre?</li> <li>2. A mund të mendoni mbi disa mënyra se si OSHC-të mund të bashkëpunojnë me SS-të për të adresuar sfidat me të cilat SS-të përballen në Shqipëri?</li> <li>3. Si mendoni se SS-të mund të mbështeten më mirë nga Rrjeti juaj? Nga qeveria? Nga institucionet burimore (agjencitë donatore, institucionet akademike, OSHC-të, etj.)?</li> <li>4. Si mund të bashkëpunojnë SS-të dhe OSHC-të për të nxitur/zhvilluar rolin e SS-ve si aktorë ndikues në zhvillimin e qëndrueshëm?</li> <li>5. Si mund të bashkëpunojnë SS-të dhe OSHC-të për të ndikuar në zhvillimin e diskutimeve bashkëpunuese (asistenca zhvillimore bilaterale dhe multi-laterale, remitancat, mobilizimi i burimeve vendase, etj.) në fuqizimin e rolit të SS-ve si aktorë, dhe të sipërmarrjes si një mënyrë/qasje e zhvillimit të qëndrueshëm?</li> </ol>

## Matrica 4: Pyetjet kryesore kërkimore për udhëheqësit / stafin kyç të SS-ve

Objektivat e Kërkimit	Pyetjet kryesore
<p>Fusha e veprimit e SS-së</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në cilin vit filloi operimin SS-ja juaj? Cilat ishin rrethanat që çuan në krijimin e saj? Ju lutemi, përshkruani me detaje fillimin e SS-së.</li> <li>2. Cili ishte kapitali i investuar (kapitali fillestar) për ngritjen e SS-së tuaj? Cila është vlera e SS-së tuaj tani, në terma të aseteve?</li> <li>3. Sa të punësuar me pagesë ka sipërmarrja juaj sociale? Sa prej tyre janë femra?</li> <li>4. Në çfarë forme ligjore është regjistruar sipërmarrja juaj sociale? (p.sh. kooperativë, person fizik, korporatë, etj.)</li> <li>5. Cilat janë produktet dhe shërbimet që ju ofroni? Kush i blen produktet dhe/ose shërbimet tuaja?</li> <li>6. Ku i shisni produktet/shërbimet tuaja? Si i shisni ato?</li> <li>7. Cilit sektor/ grupi të varfër i shërben sipërmarrja juaj sociale? Si i angazhoni/mbështesni ata? A keni ndonjë program/formë të veçantë mbështetjeje për gratë? Sa individë nga këta sektorë (të varfër) angazhon sipërmarrja juaj sociale? Sa prej tyre janë femra?</li> <li>8. Si do ta vlerësonit angazhimin tuaj me grupet e varfra? Cilat janë pikat e forta dhe kufizimet e angazhimit/mbështetjes tuaj? Cilat janë përfitimet që ata kanë marrë nga ky angazhim? Si kanë ndryshuar jetët e tyre?</li> <li>9. Si po ecën SS-ja juaj për sa i përket fitimit? (rezultoni me fitim? me barazim?)</li> <li>10. Si mund ta shtoni dhe forconi ndryshe mbështetjen tuaj ndaj grupeve të varfra, veçanërisht duke marrë në konsideratë kushtet e pandemisë?</li> <li>11. A përfshin/angazhon SS-ja juaj qeverinë, OSHC-të dhe organizatat/institucionet e tjera? Si i angazhoni ata? A keni ndonjë përfitim nga angazhimi i këtyre entiteteve?</li> </ol>
<p>Identifikimi i aktorëve kryesore në sektorin e SS-ve, të cilët janë angazhuar ose mund të angazhohen në zhvillimin e advokimit për bashkëpunim</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. A mund të identifikoni disa SS të tjera në Shqipëri të cilat mendoni se kanë qenë të suksesshme në gjenerimin e të ardhurave për të përmbushur/mbështetur misionin e tyre social?</li> <li>2. A mendoni se këto SS janë të gatshme për të bashkëpunuar me SS të tjera, OJF dhe organizata të tjera mbështetëse për të advokuar për të marrë më shumë mbështetje për sektorin e SS-ve dhe të grupeve të varfra të cilave ato u shërbejnë?</li> <li>3. A mund të identifikoni organizata (institucione) shtetërore, jo-qeveritare, apo të sektorit privat në Shqipëri, të cilat ofrojnë mbështetje financiare dhe/ose teknike për SS-të? Cila është mbështetja/shërbimet e tyre specifike?</li> </ol>

<p>Përcaktimi i sfidave dhe mundësive për SS-të, duke u nisur nga konteksti dhe kushtet e vendit të tyre të operimit (Shqipërisë)</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Cilat janë çështjet dhe sfidat me të cilat përballen SS-të në Shqipëri? Cilët faktorë/rrethana pengojnë zhvillimin e tyre? Çfarë veprimesh po merren për të adresuar këto çështje dhe sfida?</li> <li>2. Nga ana tjetër, cilat janë mundësitë për SS-të në Shqipëri? Cilët faktorë/rrethana lehtësojnë zhvillimin e tyre? Si po shfrytëzohen këto mundësi nga SS-të?</li> </ol>
<p>Zbulimi i strategjive dhe rekomandimeve mbi mënyrat se si OSHC-të dhe aktorët kryesorë të SS-ve mund të bashkëpunojnë për të mbështetur më tej dhe zhvilluar sektorin e SS-ve, si një prej kontribuuesve kryesorë në zhvillimin e qëndrueshëm.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. A njihni ndonjë rrjet apo platformë bashkëpunuese, si të SS-ve, ashtu edhe të OSHC-ve në Shqipëri? Cilat janë objektivat e tyre kryesore dhe çfarë është përfituar/arritur nga puna e tyre?</li> <li>2. A mund të mendoni mbi disa mënyra se si OSHC-të mund të bashkëpunojnë me SS-të për të adresuar sfidat me të cilat SS-të përballen në Shqipëri?</li> <li>3. Si mendoni se SS-të mund të mbështeten më mirë nga qeveria? Nga institucionet burimore (agjencitë donatore, institucionet akademike, OSHC-të, etj.?)</li> <li>4. Si mund të bashkëpunojnë SS-të dhe OSHC-të për të nxitur/zhvilluar rolin e SS-ve si aktorë ndikues në zhvillimin e qëndrueshëm?</li> <li>5. Si mund të bashkëpunojnë SS-të dhe OSHC-të për të ndikuar në zhvillimin e diskutimeve bashkëpunuese (asistenca zhvillimore bilaterale dhe multi-laterale, remitancat, mobilizimi i burimeve vendase, etj.) në fuqizimin e rolit të SS-ve si aktorë, dhe të sipërmarrjes si një mënyrë/qasje e zhvillimit të qëndrueshëm?</li> </ol>





# Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

[www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)

Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate,  
kati 10, ap. 71/73, Tiranë, Shqipëri